



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.27/2018
Prishtinë, më 16.5.2018, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari – Lila, Memli Krasniqi, Gani Dreshaj, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Sala Berisha- Shala, kryetare, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Dardan Molliqaj, anëtar.

Të ftuar: z. Fehmi Mujota, zv. ministër i Ministrisë së Infrastrukturës; z. Dritan Gjonbalaj, drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil; z. Valon Prestreshi, kryetar i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Pjesëmarrës të tjerë: Avdi Kamerolli dhe Eset Berisha – MI; Fatime Hasimi dhe Ahmet Krasniqi – AKK; Samet Dalipi, Lendita Kika – Berisha dhe Besnike Ukmata AAC; Etleva Malushaj – PSD, Semra Çitaku – Ambasada Britanike, Donika Osmani – Ekonomia Online dhe Ismail Shabani – KosovaPress.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.5.2018;
3. Shqyrtimi i Pakos Legjislative për ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjeve në fushëveprimin e Ministrisë së infrastrukturës, më qëllim të harmonizimit më Ligjin për Kundërvajtje;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil – AAC për vitin 2017;
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës – AKK për vitin 2017;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 11.06.2018

Procesverbali i mbledhjes së datës 11.06.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Pakos Legjislative për ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjeve në fushëveprimin e Ministrisë së infrastrukturës, më qëllim të harmonizimit më Ligjin për Kundërvajtje

Kryesuesi e ftoj zëvendësministrin e Ministrisë së Infrastrukturës që të prezantojë Pakon legjislative për ndryshimin dhe plotësimin e projektligjeve në fushëveprimin e ministrisë për harmonizimin më Ligjin për Kundërvajtje.

Fehmi Mujota, zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës, paraqiti ekspozë në parim për ndryshimin dhe plotësimin e Pakos së projektligjeve dhe kërkoj që, me një procedurë të shkurtuar, të propozojë për miratim të gjitha ligjet dispozitat e të cilave duhet të harmonizohen me Ligjin 05/L Nr.087 për Kundërvajtje. Këto plotësime dhe ndryshime janë një ndër prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, sepse pa ndryshimin dhe plotësimin e tyre nuk mund të shqiptohen gjopa për kundërvajtje, dhe e njëjta është në dobinë dhe të mirën e interesit publik. Në vijim paraqiti listën e projektligjeve si vijon: në Ligjin nr.05/L-064 për Patentë Shoferi, për t'u harmonizuar duhet ndryshuar 9 (nëntë) nene; në Ligjin nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, për t'u harmonizuar duhet ndryshuar njëzet e 5 (pesë) nene; në Ligjin nr. 04/ L-063 për Hekurudhat e Kosovës, për t'u harmonizuar duhet ndryshuar 1 (një) nen; në Ligjin nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme, për t'u harmonizuar duhet ndryshuar 1 (një) nen; në Ligjin nr. 04/1-179, Transportin Rrugor, për t'u harmonizuar duhet ndryshuar 2 (dy) nene; dhe në Ligjin nr. 03/L-120 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rrugë nr. 2003/11. për t'u harmonizuar duhet ndryshuar 2 (dy) nene.

Pas debatit, Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Pako Legjislative për ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjeve në fushëveprimin e Ministrisë së infrastrukturës, më qëllim të harmonizimit më Ligjin për Kundërvajtje.

Dhe, Kuvendit i propozon këtë:

Rekomandim

Të miratoj në parim projektligjet si vijon:

- 1. Projektligji nr.06/L-066 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shoferi*

2. *Projektligji nr.06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës;*
3. *Projektligji nr.06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-120;*
4. *Projektligji nr.06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor;*
5. *Projektligji nr.06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor;*
6. *Projektligji nr.06/L-071 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme.*

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil – AAC për vitin 2017

Kryesuesi, ia dha fjalën kryetarit të Bordit të AAC-së, për të paraqitur raportin vjetor të AAC-së për vitin 2017.

Samed Dalipi, kryesues i Bordit të AAC tha se përveç takimeve të rregullta, bordi i AAC-së zhvillon edhe takime të tjera në bazë të nevojave, shpreh mirënjohje për stafin dhe menaxhmentin e AAC për punën e tyre dhe kjo është e shprehur edhe në raportet zyrtare të cilat marrin vlerësime pozitive. Prezantimin e raportit për vitin 2017 në detaje do ta bëjë drejtori i Përgjithshëm, z. Driton Gjonabalaj.

Driton Gjonabalaj, drejtor i Përgjithshëm i AAC-së, Autoriteti i Aviacionit Civil është përgjegjës për rregullimin e të gjitha aspekteve të sigurisë së aviacionit dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror në Republikën e Kosovës. Dëshiroj të qartësoj, se përgjegjës për garantimin e sigurimit, që dallon nga siguria, është Ministria e Punëve të Brendshme. Sigurimi i aviacionit është masat e ndërmarra për të parandaluar ndërhyrjet kriminale në operimet e aviacionit civil. AAC-ja gjatë vitit 2017 ka certifikuar Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror si organizatë trajnuese. Në këtë mënyrë ASHNA do të jetë në gjendje që brenda organizatës të kryejë një numër trajnimesh për stafin e vet. AAC-ja ka bashkëpunuar edhe institucionet tjera me përgjegjësi në aviacionin civil dhe ka afruar këshilla në përputhje me obligimet e veta që dalin nga Ligji për Aviacionin Civil. Ka marrë pjesë aktivisht në përpilimin e strategjisë së aviacionit civil, ka kontribuar në grupet punuese për përcaktimin e detajeve teknike të zgjatjes së pistës së aeroportit dhe ngritjen e nivelit të sistemit instrumental të aterimit, ka punuar në procesin e normalizimit të hapësirës së ulët ajrore, duke përfshirë edhe hartimin e koncept dokumentit për qëndrimet që duhet të mbajnë institucionet tona të shtetit, ka marrë pjesë në negocimin e marrëveshjes së shërbimeve ajrore me Britaninë e Madhe për periudhën pas BREXIT si dhe ka riaktualizuar me MPJ dhe MI analizën ligjore për mundësinë e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil. AAC-ja ka përmbushur 100% detyrimet e veta gjatë vitit 2017 sa i përket planit kombëtar për zbatimin e MSA-së. Në Raportin e BE-së për Kosovën (ish-raport i progresit), mbi të gjitha falë punës së AAC-së është thënë pa ekuivoke se Kosova ka pasur PROGRES. Edhe vitin e kaluar AAC-ja ka vazhduar përpjekjet për të hyrë në aranzhime kontraktuale me Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit. Deri tash, përkundër përpjekjeve të vazhdueshme dhe takimeve me drejtorin e EASA-s, kjo ka qenë e pamundur për

shkak të konsideratave politike të brendshme në BE dhe EASA. AAC-ja është ri certifikuar me standardin me të ri të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015. Plani i punës për vitin 2017 është zbatuar 94%, ndërsa buxheti është realizuar 96%. Gjatë vitit 2017 nuk ka pasur asnjë incident serioz që ka rrezikuar sigurinë e aviacionit në vendin tonë. Ka pasur disa raportime joprofesionale në media, përmes së cilave është aluduar në rrezikim të sigurisë aviacionit. AAC-ja rikonfirmon se në asnjë moment gjatë vitit 2017 siguria e aviacionit civil në Republikën e Kosovës nuk ka qenë e rrezikuar. Asnjë kompani ajrore që operon në Kosovë nuk ka shprehur në AAC asnjë lloj shqetësimi rreth rrezikimit të pretenduar të sigurisë nga disa media. Ka vazhduar bashkëpunimi i ngushtë me Federatën Aeronautike të Kosovës. Pas licencimit të pilotëve dhe instruktorëve, tash së fundmi janë licencuar edhe ekzaminuarit e parë. AAC-ja gjithashtu ka lëshuar një numër të konsiderueshëm të gjobave, të shumtën për përdorim të paautorizuar të dronëve. AAC-ja edhe gjatë vitit 2017 ka vazhduar me nxjerrjen e akteve normative për të transponuar në rendin tonë të brendshëm ligjor Rregulloret dhe Direktivat përkatëse të BE-së. Deri në fund të vitit 2017, AAC-ja ka nxjerrë 110 Rregullore në zbatim të Ligjit për Aviacionin Civil dhe detyrimeve ndërkombëtar të Republikës së Kosovës që dalin nga Marrëveshja për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit.

Gani Dreshaj pyeti rreth mundësisë së shkurtimit të pritjeve të gjata që ndodhin gjatë kontrollit të pasaportave, sidomos gjatë vikendeve që është shumë i stërzgatur, si dhe parashtrij pyetje rreth çmimeve të larta të parkingut. Pyeti edhe për mundësinë e funksionalizimit të Aeroportit të Gjakovës, për shkak se sa herë që ka mjegull detyrohemi si pasagjerë të aderojmë në aeroportet e shteteve të rajonit, kur në fakt kjo do të mund të ishte mundësi e mirë për ta shfrytëzuar Aeroportin e Gjakovës.

Memli Krasniqi pyeti në lidhje me licencat e aviokompanive që operojnë, sa janë të licencuara në këtë vit, dhe cilat janë dallimet në mes të viteve 2016 dhe 2017 sa i përket këtyre licencave. Kurse u interesua të dijë më shumë rreth kompanisë Adria, se a ka të drejtë që në emër të saj të operoj kompani tjetër, e cila nder të tjera nuk përmbush kriteret e sigurisë gjatë operimit, ku edhe rrëfeu një rast personal, ku Adria duke bërë këso ndryshimesh të itinerarit janë malltretuar udhëtarët..

Mimoza Kusari – Lila shtrij pyetje rreth kompanisë Adria e cila nder të tjera në mungesë të udhëtareve shtynë fluturimet, por edhe ndërron destinacionin e fluturimit me qëllim të mbledhjes së udhëtareve në aeroportet e tjera. Sistemi i sigurisë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës na shqetëson, në lidhje me një test të sigurisë që është realizuar, jemi të informuar që persona të armatosur kanë arritur të kalojnë të gjithë mekanizmat e sigurisë gjatë një sprove që i kanë bërë menaxhmentit të sigurisë në këtë aeroport, sa janë të vërteta këto?

Kryesuesi pyeti rreth realizimit të rekomandimeve që janë dhënë nga Komisioni lidhur me raportin e vitit 2016, si dhe kërkoj të merren parasysh të gjeturat e analizës së INDEP-it.

Driton Gjonbalaj – AAC; sa i përket pritjeve të gjata në sportele nuk është në kompetencën tonë kjo gjë pasi këto kontrole bëhen nga Policia e Kosovës. Sa i përket parkingut afatgjatë në marrëveshjen e koncesionit, tarifata komerciale që nuk lidhen me shërbimet aeronautike të afuara në aeroport janë në diskrecion të operatorit të aeroportit. Po ashtu shqetësimi rreth shtrenjtimit të biletave, sidomos gjatë sezonit veror është i drejtë. Ne jemi të njoftuar me

veprimet që mund të bëjnë shkelje të konkurrencës së lirë, përsëri çështja e biletave është jashtë fushëveprimit të AAC-se. Kurse sa i përket mjegullës në aeroportin e Prishtinës është e shumë e vërtetë që në shumë ditë gjatë vitit kemi mjegull dhe si rezultat avionët në shumë raste aderojnë në aeroportet alternative, pra në ato të rajonit. Lajm i mirë është se Qeveria e Republikës së Kosovës ka nënshkruar një kontratë për ngritjen e nivelit të sistemit instrumental të aderimit, me implementimin e këtij projekti mund të fluturojnë pa problem me një dukshmëri të gjatë dhe në bazë të parashikimeve tona me këtë sistem në të ardhmen nuk do të ketë anulime për shkak të mjegullës. Sa i përket Aeroportit të Gjakovës, në kemi të gjitha kapacitetet e nevojshme të certifikimit të aeroportit të dytë në Kosovë, por duhet të sigurohemi që kjo të mos cenoj marrëveshjen me koncesionin për hapjen e aeroportit tjetër. Aplikimi për certifikim duhet të bëhet nga menaxhmenti i aeroportit të Gjakovës, të bëhet një biznes plan dhe pastaj të shihet nëse cenohet marrëveshja me koncesionarin. Konsumatori ka të drejtën e informimit nga kompania që operon fluturimin, sa i përket leasing-ut brenda kompanive ajrore në shtetet e BE-se dhe nuk ka me asnjë lloj kufizimi. Sa i përket operimit me një avion të një kompanie tjetër përderisa është i BE-se është detyrim i joni ta njohim si të tillë pa kërkuar informacione shtesë, kjo vije nga marrëveshja për hapësirën e përbashkët të aviacionit. Ne vendin tone është e transpozuar rregullorja e BE-se 261/2004 e cila mbron të drejtat e qytetarëve në rast të anulimit të fluturimeve, në rast se shiten me shumë bileta se sa ka udhëtarë në aeroplan si dhe nëse ka vonesa më shumë se sa 3 orë ata mund të kompensohen nga kompania operuese.

Memli Krasniqi: a vlen kjo edhe në rastet kur fluturimet shtyhen ose anulohen për shkak të gjendjeve të jashtëzakonshme – kushteve atmosferike e të ngjashme?

Driton Gjonbalaj – AAC; kjo rregullore e përjashton kompensimin në raste kur anulimet e fluturimeve ose vonesat shkaktohen për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme. Sa i përket kalimit të disa personave me armë në aeroportin e Prishtinës, mbrojtja e Aeroportit të Prishtinës është kompetence e Ministrisë së Punëve të Brendshme, nuk kam kompetencë që të jap informata të tjera rreth kësaj çështje. Sa i përket rekomandimeve që janë bashkangjitur nga Komisioni i Juaj në raportin e kaluar mund të them se janë realizuar suksesshëm ato rekomandime nga ana e AAC-së. Po ashtu përmendet një analizë të INDEP-it, ne e kemi marrë këtë analizë, e dimë kontributin e INDEP-it në përkrahje të agjencive të pavarura, por kësaj radhe INDEP është dashtë të tërhiqet nga kjo analizë për shkak të konfliktit të interesit, sepse ish z. drejtori i ASHNA z. Bujar Ejupi është vëllai i drejtorit ekzekutiv të INDEP-it, z. Burim Ejupi. Në këtë analizë me lehtësi të mëdha thuhet gjëra të cilat nuk qëndrojnë, siç janë çështja e gjeneratorëve rezervë, prishja e radarëve etj.

Kryesuesi, përkundër kësaj, tha se duhet të na jepni informata lidhur me këto të gjetura, siç janë gjeneratorët rezervë dhe prishja e radarëve.

Driton Gjonbalaj – AAC-; është standard të kemi një burim primar dhe një burim sekondar të energjisë elektrike, gjithashtu kemi UPS që sigurojnë 4 deri në 6 orë energji elektrike edhe nëse bie edhe burimi primar dhe ai sekondar. Sa i përket radarit ka pasur një prishje të radarit dhe çdo procedurë në aeroportin e Prishtinës ka edhe procedurën rezervë, kjo prishje në asnjë moment nuk rrezikon operimin e aviokompanive.

Hykmete Bajrami: a janë të informuar qytetarët që ekziston një procedure e kompensimit për fluturimet e dështuara apo të vonuara? A është e përkthyer rregullorja e BE-së që rregullon këtë çështje në gjuhën shqipe?

Driton Gjonbalaj – AAC; kjo rregullore dhe është në fuqi në Republikën e Kosovës që nga viti 2009 dhe është e përkthyer në dy gjuhët zyrtare, si dhe janë të ekspozuara postera më të drejtat e udhëtarëve në hapësira të aeroportit, po ashtu ka edhe aplikacion në telefona të mençur që mund të instalohet në telefon.

Gani Dreshaj; si është i rregulluar licencimi i helikopterëve privat?

Driton Gjonbalaj – AAC; sa i përket kësaj licence të helikopterëve privat në mund të afrojmë licencë në koordinim edhe me KFOR-in për çështje të sigurisë.

Pas debatit, komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

I. Kuvendi të miratojë Raportin vjetor i punës së Autoritetit të Aviacionit Civil- AAC, për vitin 2017:

II. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet deputeti, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë i komisionit.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës – AKK për vitin 2017

Kryesuesi theksoi së për këtë pikë të rendit të ditës kemi ftuar përfaqësuesin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, z. Valon Prestreshi, të cilit ia dha fjalën që të e prezantojë Raportin vjetor të AKK-së për vitin 2017.

Valon Prestreshi, kryesues i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK), theksoi se raporti është gjithëpërfshirës ku përmban punët, aktivitetet dhe të arriturat e AKK-së në kuadër të fushëveprimit të saj. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës menaxhohet nga Komisioni i AKK-së i përbërë nga 5 anëtarë. Komisioni i AKK-së vendos kolektivisht për të gjitha çështjet e konkurrencës, ndërsa kryetari i Komisionit udhëheq, organizon dhe drejton punën dhe veprimtarinë e Autoritetit dhe është përgjegjës për punën profesionale të Autoritetit. Komisioni miraton vendimet e tij në mbledhjet e tij, me shumicën e votave, ku asnjë anëtar i komisionit nuk mund të abstenojë nga votimi. Gjatë vitit 2017 Autoriteti i Konkurrencës ka arritur që në një masë mbresëlënëse t'i realizojë dhe zbatojë masat legjislative dhe masat zbatuese të MSA-së. Kemi arritur që 100% t'i përmbushim detyrat dhe objektivat të cilat ishin pjesë e Agjendës për Reforma Evropiane. Në kuadër të kësaj agjende Autoriteti ka draftuar dhe miratuar 6 akte nënligjore, Udhëzimet Administrative për përjashtimin në bllok të marrëveshjeve vertikale dhe horizontale dhe Rregulloren për procedurat hetimore të AKK-së. Autoriteti po ashtu ka hartuar strategjinë për zbatimin e ARE-së, me të cilën është përcaktuar puna dhe udhërrëfyesi konkret në identifikimin dhe hulumtimin e monopoleve në tregun e Republikës së Kosovës. Autoriteti

ka arritur që brenda afateve të bëjë identifikimin dhe hulumtimin e monopoleve në 13 tregje dhe të afrojë rekomandime të duhura drejt rregullatorëve përkatës. Autoriteti gjithashtu ka siguruar që të jetë përfitues i projektit të madh të Komisionit Evropian IPA 2018, për të cilën pardje, u dakorduar për punët që do të implementohen për përdhën 3 vjeçare. Në fund theksoi se kanë marrë vlerësim pozitiv nga Raporti i Progresit i BE-së për Kosovën.

Gani Dreshaj pyeti për çështjen e blerjes në treg dhe, sipas tij, pse duhet të bëhen kontrata te noteri? Pse me bë te noteri, kur ne mund të bëjmë kontratë të shkruar ose në të folur. Dhe sa të punësuar ka Autoritetit Kosovar të Konkurrencës?

Hykmete Bajrami pyeti se a kanë mundësi t'i trajtojnë ndihmat shtetërore në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Ndhima shtetërore që po jepet, a po i trajtoni si subvencionet? Sa ndëshkime i keni dhëne gjatë vitit raportues? Sa kohë ju duhet më shpenzuar nëpër gjykatë më qenë se dimë së keni kapacitetet e kufizuara dhe nuk mund të jeni prezent në terren? Gjithashtu ju përgëzoi për projektet që keni fituar nga BE-ja, po ashtu dhe neve si Kuvend dhe komisioni duhet t' ju ndihmojmë në aspektin e autoritetit që ju jep ligji. Ajo tha se ekziston edhe tregu me monopol, siç është rasti me homologimin e automjeteve, prandaj duhet të ndryshohet legjislacionin sepse në këto rast nuk mund të bëjë asgjë AKK-ja dhe nëse dërgohen lëndët në Gjykata i humbin rastet, shkak i legjislacionit që i favorizon qoftë ndërmarrjet publike apo kompanitë private.

Mimoza Kusari- Lila pyeti për rastin e Postës të zonës së rezervuar nëpër ministri të caktuar dhe komuna dhe në atë kohë nëse ka pasur marrëveshje më bankat komerciale për pagesa tani a janë tërhequra? Ndonëse nuk ka kaluar nëpër proces të hapur konkurruese. Tek rasti i Postës është vlerësuar së nuk keni pas kompetencë si AKK ku qëndron problemi?

Memli Krasniqi tha për të Posta mendoj së kjo ka qenë për vendet rezervuara që është kuptueshme dhe normale brenda institucioneve publike me bashkëpunuar për shërbimet qytetareve dhe te kontratat e shërbimeve mobile kemi pas shmangie të mos respektimit të institucioneve publike, kur Qeveria është aksionar 100% e Postës kemi pas marrëveshje më operatorët privat. Pyeti a janë gjatë tërë vitit 2017 veç 18 rast të dënimeve? Dhe sa prej tyre i keni iniciuar ju si AKK dhe sa kanë ardhur si pjesë e ankesave? Tek IPA 2018 thatë se keni përfituar projekte, a mund të na sqaroni më shumë për këtë projekte sepse IPA 2018 as nuk është gati për zbatim. Ndërsa, lidhur për dënimet që i ka shqiptuar Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në gjykata kush e përfaqëson AKK-ën, dhe sa po zgjasin shqyrtimet e lendeve në seancat gjyqësore?

Valon Prestreshi, AKK, tha se nuk kanë kompetencë për çështjen e kontratave të noteri, në këtë çështje kemi kompetencë të lejojmë një përqendrim kur një kompani e blen një kompani tjetër, siç është Emona bleu Interexin. Se sa te punësuar ka AKK-ja, tha janë 13 shërbyes civilë dhe 5 komisionarë.. Për Ndhimat shtetërore, tha që Ndhimat shtetërore kanë kaluar në Ministrinë e Financave me ligjin e ri. Tek rasti i Postës, tha është lëndë tjetër e vitit 2016 që është trajtuar dhe në Gjykatë dhe është mbyllur. Për projektin IPA 2018, tha që e kanë aplikuar ne tender të Komisionin Evropian dhe presin që gjatë vitit 2018 të filloj të realizohen projektet.

Ahmet Krasniqi, anëtarë i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës theksoi se kanë reaguar ndaj një Udhëzimi administrativ për shtrembërimin e konkurrencës në tregun e homologimit. Ai tha se ka mbetur që në këtë javë të ulen së bashku me drejtues të Ministrisë së Infrastrukturës për harmonizimin e tij me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës.

Kryesuesi tha së për këtë çështje është dashur të njoftohet dhe Komisioni ynë, si Komision mbikëqyrës, në mënyre që ta paraqesim dhe ta trajtojmë të ministrat përgjegjës, e që edhe ata e kanë për detyrë që raportojnë Komision. Dhe për këtë kërkoi që të sjellët më shkrim një raport më njoftim.

Valon Prestreshi, AKK, lidhur më shqiptimin e dënimeve tha që përfaqësohen nga zyrtarët ligjore të AKK-së në gjykata, por në gjykata po kemi kohëzgjatje dhe në disa raste po i humbim lëndet për shkak të çështjeve procedurale. Andaj, deri më tani kemi pas shumë kohëzgjatje me gjykata, ka 7 vjet jemi duke u marrë me lëndë nëpër gjykata. Prandaj po shikojmë mundësin të organizojmë trajnime me gjyqësorin t'u mbajmë disa ligjërata për ligjin e mbrojtjes së konkurrencës, ne po i humbim lëndët për shkak se ata nuk po e njohin ligjin material.

Në mungesë të kuorumit për vendimmarrje, Komisioni nxori këtë:

Konkluzion

Shtyhet për mbledhjen e radhës votimi i Raportit vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës – AKK për vitin 2017.

6. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Zëvendëskryetar i parë i Komisionit,

Dardan SEJDIU